| 241 | METO | SADIK | JAUPAJ | 88 | 16.2.2021 | | | 34 | 1645 | SULO | UMBERTO | RESULI | | | 34 | 12458 | 423572 | ME VKM-në NR. 118, DATË 17.2.2011, ËSHTË MIRATUAR 300 m², ME VKM-në NR. 901, DATË 12.12.2012, ËSHTË BËRË KOMPENSIMI I PRONARIT PËR SIPËRFAQEN 266 m² |
| 242 | METO | SADIK | JAUPAJ | 113 | 1.3.2021 | | | 25.1 | | | | | | | 25.1 | 12458 | 312695.8 | ME VKM-në NR. 118 DATË 17.2.2011, ËSHTË MIRATUAR 155.1 m², ME VKM-në NR. 901, DATË 12.12.2012, ËSHTË BËRË KOMPENSIMI I PRONARIT PËR SIPËRFAQEN 130 m². |
| 243 | AVDUL | AZEM | LLAKA | 120 | 5.3.2021 | | | 365 | | | | | | | 365 | 12458 | 4547170 | |
| **QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 3981** | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 244 | ISUF | QERIM | RAMAJ | 23991 | 17.2.2016 | | | 267 | 1646 | KOZMA | NAUN | SEMINI | 272 | 268/70 | 267 | 2270 | 606090 | |
| 245 | RESHAT | ISMAHIL | QALLIJA | 239877 | 6.5.2016 | | | 282 | | | | | | | 282 | 2270 | 640140 | |
| 246 | ISMET | IDAJET | ABAZAJ | 240123 | 7.3.2016 | | | 206 | | | | | | | 206 | 2270 | 467620 | |
| 247 | TODHE | MITRO | KAPEDANI | 272524 | 29.5.2018 | | | 422 | | | | | | | 422 | 2270 | 957940 | |
| 248 | SULO | LAMCE | JAUPAJ | 239572 | 29.1.2016 | | | 268 | | | | | | | 268 | 2270 | 608360 | |
| 249 | GEZIM | ELMAS | KERRI | 272363 | 23.5.2018 | | | 396 | | | | | | | 396 | 2270 | 898920 | |
| 250 | AGRON | FUAT | TOSKA | 236837 | 20.3.2015 | | | 310 | | | | | | | 310 | 2270 | 703700 | |
| 251 | THOMA | KRISTAQ | BACAJ | 236770 | 21.12.2017 | | | 415 | | | | | | | 415 | 2270 | 942050 | |
| | LAVDIE | MYNYR | BACAJ | | | | | | | | | | | | | | | |
| 252 | SAFET | IDAJET | ABAZAJ | 241484 | 30.5.2016 | | | 269 | | | | | | | 269 | 2270 | 610630 | |
| 253 | BESNIK | IDAJET | ABAZAJ | 141 | 14.3.2021 | | | 446 | | | | | | | 446 | 2270 | 1012420 | |
| 254 | BARJAM | LAMÇE | JAUPAJ | 238750 | 8.10.2015 | | | 315 | | | | | | | 315 | 2270 | 715050 | |
| 255 | SHEFQET | FECOR | ZEQO | 271715 | 29.3.2018 | | | 391 | 1647 | KOZMA | NAUN | SEMINI | 273 | 268/71 | 391 | 2270 | 887570 | |
| 256 | FATMIR | RIZA | MUHAJ | 247362 | 25.8.2016 | | | 303 | | | | | | | 303 | 2270 | 687810 | |
| 257 | ALUSH | MUJO | MUHAJ | 234561 | 27.3.2015 | | | 323 | | | | | | | 323 | 2270 | 733210 | |
| 258 | BLEDAR | NAMIK | ZYKA | 236765 | 19.12.2017 | | | 341 | | | | | | | 341 | 2270 | 774070 | |

**VENDIM**
**Nr. 56, datë 26.1.2022**

# PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE TË SIGURISË, PËRGJEGJËSIVE DHE MËNYRAVE TË RUAJTJES SË SIGURISË NË VEPRIMTARITË SPORTIVE DHE NDESHJET E FUTBOLLIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 51, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit e të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Objekti

Ky vendim përcakton masat e sigurisë, përgjegjësitë dhe mënyrat e ruajtjes së sigurisë në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit, me qëllim sigurimin e një mjedisi të qetë, të sigurt e mirëpritës gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre.

### Neni 2
### Përkufizime

Për qëllimet e këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Dhoma e kontrollit", dhoma e rezervuar për stafin e zyrtarët me përgjegjësi për çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë, që lidhen me veprimtaritë sportive, përkatësisht punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, oficeri i sigurisë i organizatës sportive, organizatore e veprimtarisë sportive, oficeri i sigurisë së mjedisit sportiv dhe stafi i tyre;

b) "Masat e sigurisë", masat e synuara a të zbatuara me qëllim kryesor parandalimin, uljen e rrezikut dhe reagimin ndaj çdo forme dhune ose aktiviteti tjetër kriminal apo prishjeje të rendit e të sigurisë publike, të kryer në lidhje me një veprimtari sportive, brenda ose jashtë një mjedisi sportiv;

c) "Mjedis sportiv", një hapësirë e mbuluar ose jo, e rrethuar ose jo, e destinuar për organizimin e veprimtarive sportive, si: lojëra sportive, gara sportive, palestra sportive ose *fitness*-i apo e përdorur përkohësisht për organizimin e veprimtarive sportive promocionale, lojërave zbavitëse dhe veprimtarive sportive rekreative;

ç) "Oficeri ndërlidhës për tifozët", personi që vepron si pika kryesore e kontaktit për tifozët e një organizate sportive;

d) "Organizatori i veprimtarisë sportive", një ose disa organizata sportive ose entitete të tjera, përgjegjëse për organizimin e një veprimtarie sportive;

dh) "Personeli i sigurisë", punonjësit e Policisë së Shtetit, të Policisë Bashkiake dhe të sigurisë private, të angazhuar me ruajtjen e rendit e të sigurisë publike në një veprimtari sportive;

e) "Punonjës sigurie", një individ i trajnuar, i cili ushtron funksionet e përcaktuara të mbrojtjes e të sigurisë në mjedisin sportiv dhe përreth tij;

ë) "Qasje e integruar", qasja, që, pavarësisht nga qëllimi i tyre kryesor, masat e rendit, sigurisë dhe shërbimit në veprimtaritë sportive janë të ndërlidhura, në kuptimin e ndikimit, dhe të balancuara e nuk mund të projektohen dhe të zbatohen të izoluara;

f) "Sistemi i adresimit të publikut", një sistem elektronik i altoparlantëve, i aftë për të komunikuar në çast mesazhe të qarta për të gjithë tifozët e pjesëmarrësit;

g) "Sistemi i kamerave me qark të mbyllur", sistemi me kamera fikse me lëvizje horizontale dhe vertikale për monitorimin e tifozëve, të rrugëve, të hyrjeve dhe të zonave të shikimit brenda mjedisit sportiv.

## KREU II
## PËRGJEGJËSITË PËR RUAJTJEN E SIGURISË NË VEPRIMTARITË SPORTIVE

### Neni 3
### Detyrat e federatave shqiptare sportive

1. Federata shqiptare e një sporti të caktuar, për organizimin e veprimtarive zyrtare me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë, merr masa për parandalimin e dhunës, si dhe promovon *fair-play*-n e tolerancën.

2. Federata shqiptare e një sporti të caktuar harton rregulloren me masat e sigurisë, përgjegjësitë dhe mënyrat e ruajtjes së sigurisë në veprimtaritë

sportive zyrtare, kombëtare dhe ndërkombëtare, që zhvillohen prej saj apo prej organizatave sportive, anëtare të saj, në përputhje me kategorinë e veprimtarisë sportive.

3. Rregullorja, sipas pikës 2 të këtij neni, miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Federatës, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe është e detyrueshme për zbatim nga organizatat sportive, anëtare të federatës.

4. Federata shqiptare e një sporti të caktuar duhet të njoftojë ministrinë përgjegjëse për sportin, Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga miratimi i rregullores, sipas përcaktimeve të këtij neni.

Neni 4
**Kategorizimi i veprimtarive sportive**

Referuar rëndësisë dhe nivelit të vështirësisë në organizimin dhe në administrimin e tyre, veprimtaritë sportive kategorizohen, si më poshtë vijon:

a) Kategoria 1, veprimtaria sportive ndërkombëtare, ku parashikohet pjesëmarrje masive e tifozëve dhe e pjesëmarrësve e me ndikim të madh, si dhe çdo veprimtari tjetër sportive, që klasifikohet nga organizatorët, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, si veprimtari me risk të lartë;

b) Kategoria 2, veprimtaria sportive ndërkombëtare, ku parashikohet pjesëmarrje masive e tifozëve dhe e pjesëmarrësve e me ndikim rajonal apo më gjerë, apo veprimtari sportive kombëtare, ku parashikohet pjesëmarrje masive e tifozëve, e cila, nga organizatorët, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, klasifikohet si veprimtari me risk të mesëm;

c) Kategoria 3, veprimtaria sportive kombëtare me pjesëmarrje të vogël tifozësh, e cila, nga organizatorët, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, klasifikohet si veprimtari me risk të ulët;

ç) Kategoria 4, veprimtaria sportive lokale me pjesëmarrje të sportistëve të moshave të vogla, e cila, nga organizatorët, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, klasifikohet si veprimtari me risk të ulët.

Neni 5
**Oficeri i sigurisë**

Për veprimtaritë sportive të kategorive 1 dhe 2 merren masat e mëposhtme për ruajtjen e sigurisë:

a) Organizatori i veprimtarisë sportive cakton oficerin e sigurisë, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, i cili është:

i. oficeri i sigurisë i organizatës sportive, organizatore e veprimtarisë sportive;

ii. oficeri i sigurisë i mjedisit sportiv.

b) Oficeri i sigurisë:

i. mban kontakte me autoritetet e Policisë së Shtetit, shërbimet mjekësore dhe oficerin ndërlidhës për tifozët;

ii. përgjigjet për vlerësimin dhe raportimin tek organizatori i veprimtarisë sportive, duke marrë masa që ata të mos ndikojnë në sigurinë e veprimtarisë;

iii. përgjigjet për vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve, si dhe për marrjen e masave në koordinim me Policinë e Shtetit, shërbimet e emergjencës, autoritetet publike dhe çdo subjekt tjetër të përfshirë në menaxhimin e ngjarjes;

iv. zhvillon, zbaton e rishikon politikat dhe procedurat e mbrojtjes e të sigurisë, duke përfshirë menaxhimin dhe planifikimin e rreziqeve;

v. menaxhon operacionet e mbrojtjes e të sigurisë në veprimtarinë sportive;

vi. në bashkëpunim me organizatorin e veprimtarisë sportive, siguron që infrastruktura, sistemet dhe pajisjet e mjedisit sportiv të jenë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë sportive.

Neni 6
**Bashkëpunimi me autoritetet publike**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive është përgjegjës për ndërlidhjen me autoritetet publike në territorin, ku organizohet veprimtaria sportive, për të siguruar bashkëpunimin e koordinimin me to në zbatimin e masave.

2. Në bashkëpunim me autoritetet publike, organizatori i veprimtarisë sportive përfshin procedura të qarta për çështje, që ndikojnë në menaxhimin e turmës dhe rreziqet e mbrojtjes e të sigurisë, në veçanti, të përdorimit të lëndëve

piroteknike, të sjelljeve të dhunshme, raciste ose diskriminuese, në përputhje me legjislacionin.

3. Administratorët e mjediseve sportive marrin masa për caktimin e një ambienti të përshtatshëm për drejtuesit e njësisë policore për monitorimin e situatës së rendit e të sigurisë në mjedisin sportiv.

Neni 7
**Detyrimi për informim**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1, 2 dhe 3 njofton zyrtarisht Policinë e Shtetit për kalendarin e veprimtarive sportive para nisjes së sezonit sportiv, si dhe për çdo ndryshim të bërë gjatë sezonit.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1, 2 dhe 3 është i detyruar të njoftojë me shkrim Policinë e Shtetit dhe njësitë e qeverisjes vendore, të paktën 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara zhvillimit të saj, me qëllim planifikimin e të gjitha masave të nevojshme të sigurisë për mbarëvajtjen e saj për:

a) vendin, datën dhe orën e organizimit të veprimtarisë;

b) numrin e tifozëve, që priten të marrin pjesë;

c) kontaktet e nevojshme të zyrtarëve të veprimtarisë, të oficerit të sigurisë apo informacione të tjera të dobishme;

ç) shërbimin privat të sigurisë fizike (SHPSF), policinë bashkiake apo shoqatën e vullnetarëve, agjenci të specializuara të shërbimit të kontraktuara për marrjen e masave të sigurisë dhe të shërbimit në mjediset sportive, si dhe numrin e punonjësve të saj, që do aktivizohen në rolin e personelit të sigurisë, përpara, gjatë dhe pas veprimtarisë sportive;

d) vendimet e marra nga komisionet përkatëse të federatës, nëse ka të tilla, për shkeljet e konstatuara lidhur me veprimtarinë sportive.

3. Organizatori i veprimtarisë sportive njofton e merr masa për pjesëmarrjen në veprimtari të subjekteve të tjera, si:

a) shërbimi i ndihmës së parë, urgjenca mjekësore dhe Kryqi i Kuq;

b) SHPSF-ja, kontraktuar për mbulimin e shërbimit të sigurisë, apo policia bashkiake;

c) struktura e operatorit publik të energjisë elektrike për masat në sigurimin e rrymës elektrike në mjedisin sportiv.

4. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1 dhe 2, përveç subjekteve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, njofton për pjesëmarrjen në veprimtari edhe Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

5. Policia bashkiake apo SHPSF-ja, e kontraktuar nga organizatori i veprimtarisë sportive për mbulimin e shërbimit të sigurisë, njofton zyrtarisht Policinë e Shtetit:

a) 5 (pesë) ditë para organizimit të veprimtarisë sportive, për:

i. marrjen përsipër të ofrimit të shërbimeve të sigurisë përpara, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes;

ii. kontratën e nënshkruar me organizatorin e veprimtarisë, si dhe numrin e punonjësve, që do të angazhohen me shërbim;

iii. planin e dislokimit të punonjësve të sigurisë, brenda dhe jashtë mjedisit sportiv;

b) për incidentet e ndodhura gjatë kryerjes së shërbimit.

6. Policia e Shtetit informon zyrtarisht organizatorin e veprimtarisë sportive, për:

a) masat e marra për garantimin e sigurisë së veprimtarisë;

b) personat e kontaktit në strukturat qendrore apo vendore të Policisë së Shtetit:

c) problemet e mangësitë e konstatuara;

ç) masat administrative të marra ndaj tifozëve apo grup-tifozëve për shkeljet e ndryshme të konstatuara.

7. Policia e Shtetit mund të informojë organizatorin e veprimtarisë sportive të një sporti të caktuar mbi bazën e kërkesës me shkrim, për procedimet penale ndaj personave që janë në proces hetimi ose gjykimi apo që janë dënuar për veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal lidhur me veprimtaritë sportive të atij sporti.

Neni 8
**Identifikimi i personave përgjegjës dhe inspektimi i mjedisit sportiv**

Organizatori i veprimtarisë sportive:

a) identifikon punonjësin e Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, dhe zyrtarin e mbrojtjes e të sigurisë;

b) identifikon të gjithë individët e tjerë përgjegjës për mbrojtjen dhe sigurinë, shërbimet mjekësore dhe zjarrfikësit;

c) siguron që mjedisi sportiv i veprimtarisë të inspektohet imtësisht dhe të jetë lëshuar një certifikatë sigurie nga autoriteti përgjegjës. Certifikata e sigurisë të jetë e vlefshme para datës së veprimtarisë sportive dhe vendoset në dispozicion të federatës kombëtare ose ndërkombëtare, sipas kërkesës dhe kategorisë së veprimtarisë sportive.

Neni 9
**Koordinimi i personelit të sigurisë**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1 dhe 2 dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, bien dakord për strukturën e komandës e të kontrollit për veprimtarinë sportive dhe sigurojnë që ajo të jetë e dokumentuar, duke përshkruar rrethanat, kur kontrolli i mjedisit sportiv transferohet nga organizatori i veprimtarisë sportive te Policia e Shtetit.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive siguron që të ketë punonjës sigurie dhe/ose vullnetarë, për të garantuar sigurinë e tifozëve dhe të pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive brenda mjedisit sportiv dhe të publikut në ambientet rrethuese në afërsi.

3. Policia e Shtetit është në dispozicion për të mbështetur punonjësit e sigurisë dhe SHPSF-në, për të përballuar shpërthimin e dhunës ose prishjen e rendit.

Neni 10
**Grupi i menaxhimit të sigurisë së veprimtarisë sportive (GMSVS)**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1 dhe 2 krijon GMSVS-në, që përfshin:

a) një zyrtar të lartë, i cili vepron në emër të organizatorit të veprimtarisë sportive;

b) një përfaqësues të lartë nga:

i. çdo autoritet publik apo përfaqësues të agjencive, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin;

ii. punonjës të sigurisë (SHPSF, polici bashkiake apo vullnetarë);

iii. pronari apo administratori i mjedisit sportiv;

iv. ekipet pjesëmarrëse në veprimtari.

c) oficerin e sigurisë së organizatorit të veprimtarisë sportive apo të mjedisit sportiv;

ç) delegatin e organizatës sportive ndërkombëtare të sportit përkatës, nëse ka;

d) oficerin e sigurisë së organizatës sportive ndërkombëtare të sportit përkatës, nëse ka.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive identifikon një vend të përshtatshëm takimi brenda mjedisit sportiv, ku grupi takohet në rast të një incidenti të rëndë apo emergjence.

3. Anëtarët e GMSVS-së thirren për takim, nëpërmjet një shenje apo thirrjeje të shkurtër, të koduar, e cila transmetohet nëpërmjet sistemit të adresimit të publikut.

4. Organizatori i veprimtarisë sportive siguron që anëtarët e GMSVS-së të jenë në gjendje të komunikojnë lirisht me telefon ose radio me dhomën e kontrollit të mjedisit sportiv apo me një vend tjetër, ku zhvillohet takimi i GMSVS-së.

KREU III
MËNYRAT DHE MASAT PËR RUAJTJEN E SIGURISË NË VEPRIMTARITË SPORTIVE

Neni 11
**Strategjia dhe planifikimi i ndarjes së tifozëve dhe e shpërndarjes së turmave**

1. Në një veprimtari sportive, ku tifozët janë të veçuar, nga organizatori i veprimtarisë sportive, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe/ose oficerin e sigurisë, hartohet një strategji e ndarjes. Nëse është e nevojshme, kjo strategji përfshin, gjithashtu, një strategji parkimi për grupe të ndryshme tifozësh.

2. Strategjia e shpërndarjes së turmës në fund të veprimtarisë diskutohet në takimin organizativ mëngjesin para veprimtarisë.

3. Numri dhe kualifikimet e ofruesve të ndihmës të parë, të caktuar për të ofruar trajtim të ndihmës së parë për tifozët, miratohet nga autoritetet publike përkatëse, të cilat përcaktojnë gjithashtu numrin e ambulancave, që do të jenë në vend gjatë veprimtarisë sportive.

4. Ofruesit e ndihmës së parë duhet të dallohen lehtësisht.

5. Për Policinë e Shtetit, shërbimin mjekësor dhe zjarrfikësit, në përputhje me kërkesat e autoriteteve publike, duhet të ofrohen dhoma dhe ambiente të përshtatshme brenda e përreth mjedisit sportiv.

Neni 12
**Informacionet për të gjithë tifozët**

Organizatori i veprimtarisë sportive ofron informacionin e mëposhtëm për të gjithë tifozët:

a) orën e hapjes së mjedisit sportiv, ku zhvillohet veprimtaria;

b) hartën e mjedisit sportiv, brenda dhe përreth tij, duke përfshirë rrugët e hyrjes, vendparkimet, ndalesat e transportit publik dhe vendndodhjen e sektorëve të shikimit;

c) rregulloret bazë të mjedisit sportiv, duke përfshirë ndalimin e:

i. hyrjes në to nën efektin e alkoolit;

ii. zotërimit e të përdorimit të lëndëve piroteknike dhe të mjeteve ofenduese;

iii. sendeve dhe të lëndëve të ndaluara brenda mjedisit sportiv;

iv. hedhjes së ndonjë sendi;

v. hyrjes së paautorizuar në zonën e lojës;

vi. përdorimit të gjuhës raciste, homofobike, fyese dhe abuzive;

vii. qëndrimit në këmbë në një zonë me ulëse.

Neni 13
**Informacionet për tifozët miq për veprimtaritë sportive ndërkombëtare**

Për veprimtaritë zyrtare sportive ndërkombëtare në Shqipëri, organizatori i veprimtarisë i ofron, nëpërmjet faqes së tij në internet, klubit mik sa më shumë informacion që është e mundur, për t'ua shpërndarë tifozëve miq, duke përfshirë:

a) kërkesat për vizë, nëse ka;

b) kufizimet e importit doganor;

c) njësitë valutore dhe vlerat ekuivalente në monedhën vendëse;

ç) distancat nga pikat e ndryshme të mbërritjes (aeroporti, stacioni, porti) deri në qendër të qytetit dhe deri te mjedisi sportiv, ku zhvillohet veprimtaria sportive;

d) adresën e pikës së kontaktit, në raste emergjence, dhe emrin e kontaktit të organizatorit të veprimtarisë sportive jashtë vendit;

dh) adresën dhe numrin e telefonit të ambasadës ose të konsullatës lokale;

e) hartën e mjedisit sportiv, brenda dhe rreth tij, që tregon sektorët e ndryshëm, rrugët e hyrjes nga qyteti dhe vendndodhjen e zonave të caktuara të parkimit;

ë) hollësitë e shërbimeve të transportit publik nga qendra e qytetit deri te mjedisi sportiv;

f) dispozitat specifike ligjore lidhur me sjelljen e gabuar në veprimtaritë sportive në shtetin pritës;

g) sendet e ndaluara brenda mjedisit sportiv;

gj) treguesit e çmimeve mesatare për ushqimin, tarifat e taksive dhe të transportit publik;

h) paralajmërimet e autoriteteve lokale për shëndetin, nëse ka.

Neni 14
**Ekipi mik dhe tifozët, siguria e ekipit mik**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1 dhe 2 bën një vlerësim të rrezikut, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe, sa herë që nuk ofrohet shoqërimi nga Policia e Shtetit për lëvizjen e ekipeve dhe të zyrtarëve, arsyet duhet të regjistrohen në këtë vlerësim të rrezikut.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive kërkon bashkëpunimin e Policisë së Shtetit për të garantuar sigurinë e ekipit mik e të zyrtarëve të tij në hotelin e tyre dhe kur udhëtojnë për në vendin e trajnimit e të ndeshjes.

Neni 15
**Udhëtimi i tifozëve miq**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1 dhe 2 dhe federatat ose klubet e ekipeve pjesëmarrëse, pas vlerësimit të rrezikut dhe nëse këshillohet, marrin masa për të mos lejuar udhëtimin e tifozëve për ndjekjen e veprimtarisë sportive.

2. Për veprimtaritë sportive të kategorive 1 dhe 2, ku do të marrin pjesë tifozët e një klubi mik, ofrohen punonjës të sigurisë dhe oficerë ndërlidhës për tifozët nga klubi mik, për të shoqëruar e ndihmuar tifozët që udhëtojnë. Oficerët ndërlidhës për tifozët mundësojnë komunikimin për organizatorët e ndeshjes, autoritetet publike dhe tifozët. Punonjësit e sigurisë ndihmojnë tifozët gjatë udhëtimit të tyre nga vendi i nisjes drejt vendit ku do të organizohet veprimtaria sportive dhe anasjelltas. Numri i punonjësve të sigurisë të federatës ose të klubit pritës nuk duhet të ulet, për shkak të pranisë së punonjësve të sigurisë të federatës ose klubit mik.

3. Numri i punonjësve të sigurisë që udhëtojnë duhet të jetë proporcional me numrin e tifozëve që

udhëtojnë. Për çdo 500 (pesëqind) deri në 1 000 (një mijë) tifozë ofrohen 2 (dy) punonjës të sigurisë që udhëtojnë. Katër punonjës të tjerë të sigurisë që udhëtojnë ofrohen për çdo 1 000 (një mijë) tifozë shtesë ose më pak që do të udhëtojnë. Oficerët ndërlidhës për tifozët mund të përfshihen në numrin e përgjithshëm të punonjësve të sigurisë që udhëtojnë.

4. Kur federata ose klubi mik nuk i plotëson kërkesat e mësipërme për të ofruar punonjës të sigurisë që udhëtojnë, mund të vendoset si masë disiplinore një ulje e pjesshme, prej 5 (pesë) %, ose totale e numrit të biletave për ndeshjet e ardhshme, që përfshijnë federatën a klubin përkatës.

Neni 16
**Bileta dhe të dhënat e mbajtësit të saj**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive mban të dhëna personale të personave, të cilëve u shiten ose u jepen biletat, ku përfshihen emri, data e lindjes dhe adresa.

2. Të dhënat personale, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për veprimtaritë e kategorive 1 dhe 2, vihen në dispozicion, sipas kërkesës të Policisë së Shtetit, në vendin ku zhvillohet veprimtaria, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Kur biletat u ndahen palëve të treta për shpërndarje, duke përfshirë klubet e tifozëve, organizatori i ndeshjes, federata ose klubi përkatës sigurohen që këto palë të treta të mos u japin bileta marrësve, të cilët nuk kanë paraqitur dokumente identifikimi.

4. Kur pala, sipas përcaktimit të pikës 3 të këtij neni, nuk i plotëson kërkesat në lidhje me regjistrimin e të dhënave të mbajtësit dhe vënien në dispozicion të këtyre të dhënave, mund të vendoset si masë disiplinore një ulje e pjesshme, prej 5 (pesë) % ose totale e numrit të biletave për ndeshjet e ardhshme që përfshijnë këtë palë.

5. Pala, sipas përcaktimit të pikës 3 të këtij neni, ofron të gjitha informacionet e mundshme për numrin e personave që besohet se po udhëtojnë për të ndjekur një ndeshje në vendin pritës, pa bileta. Informacioni ofrohet, gjithashtu, për kërkesën e mundshme për bileta nga tifozët e ekipit mik, që jetojnë në vendin pritës.

Neni 17
**Hapja e portave të mjedisit sportiv për tifozët**

Organizatori i veprimtarisë sportive, së bashku me punonjësin e Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, dhe oficerin e sigurisë vendosin orën kur hapen dyert e mjedisit sportiv për tifozët, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

a) kapacitetin e hyrjes, i cili përcaktohet nga numri maksimal i tifozëve, që mund të hyjnë në mënyrë të sigurt në mjedisin sportiv në një periudhë njëorëshe, në bazë të normës së hyrjes ose të rrjedhës së kalimit në pajisjen rrotulluese, për mjedisin sportiv në tërësi dhe për secilin sektor të mjedisit sportiv në veçanti;

b) numrin e parashikuar të tifozëve dhe kapacitetin e përgjithshëm maksimal të sigurt të mjedisit sportiv;

c) strategjinë e ndarjes jashtë mjedisit sportiv.

Neni 18
**Kontrolli i mjedisit sportiv dhe ndalimi i hyrjes në të**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive sigurohet, që:

a) mjedisi sportiv të ruhet nga ndërhyrja e paautorizuar për një periudhë të përshtatshme para ditës së veprimtarisë sportive. Kjo periudhë përcaktohet në përputhje me vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut të ndërmarrë për veprimtarinë nga organizatori i saj dhe autoritetet publike;

b) të kryhet një kontroll i hollësishëm i sigurisë në mjedisin sportiv për persona të paautorizuar, sende dhe lëndë të ndaluara, para se të pranohen tifozët.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive bashkëpunon me njësinë e Policisë së Shtetit për t'u siguruar që çdo personi që i ndalohet hyrja në mjedisin sportiv për ndonjë nga arsyet e parashikuara nga ligji, sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë komisariatit të Policisë së Shtetit, nën juridiksionin e të cilit zhvillohet veprimtaria sportive, ku është konstatuar kundërvajtja, ose që është dëbuar nga mjedisi sportiv, të mos pranohet ose ripranohet dhe që personi të mbahet larg nga

mjedisi sportiv gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive.

Neni 19
**Tabelat treguese**

Kur sistemi i biletave është i koduar me ngjyra, që përputhet me paraqitjen e sektorit, ngjyrat e duhura duhet të shfaqen në të gjitha tabelat treguese që drejtojnë tifozët në sektorë të ndryshëm të mjedisit sportiv.

Neni 20
**Ndarja e tifozëve**

1. Nëse kërkohet nga rrethanat, ndarja e grupeve të ndryshme të tifozëve fillon sa më larg që të jetë e mundur nga mjedisi sportiv, për t'u mbrojtur nga përzierja e padëshirueshme e tyre në hyrjet e mjedisit sportiv ose në zonat e pajisjeve rrotulluese, për kalimin e vetëm një personi.

2. Për grupet e ndryshme të tifozëve sigurohen vendparkime të ndara për makinat dhe autobusët, mundësisht në anë të ndryshme të mjedisit sportiv dhe sa më afër sektorëve të tyre përkatës të shikimit.

Neni 21
**Rrugët e kalimit dhe kufizimi i lëvizjes së tifozëve**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive merr masa për të siguruar që të gjitha rrugët e kalimit të tifozëve, korridoret, shkallët, dyert, portat dhe rrugët e daljes në raste emergjente të jenë të lira nga çdo pengesë, e cila mund të pengojë kalimin e lirë të tyre.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive merr masa për t'u siguruar që tifozët të mos lëvizin nga njëri sektor në tjetrin.

3. Nëse është e nevojshme prania e më shumë se një grupi tifozësh në një sektor të veçantë, vendoset një ndarje ndërmjet tyre me anë të një barriere të kontrolluar nga personeli i sigurisë ose duke krijuar një "zonë të ndaluar", pa tifozë, ku qëndron vetëm personeli i sigurisë.

Neni 22
**Dyert dhe portat e mjediseve sportive të mbyllura**

Organizatori i veprimtarisë sportive merr masa për të siguruar që:

a) dyert dhe portat e daljes së mjediseve sportive të mbyllura, si dhe portat që lidhin zonat e tifozëve me zonën e zhvillimit të veprimtarisë sportive të jenë të shkyçura ndërkohë që ata janë në mjedis sportiv;

b) në secilën prej dyerve a portave qëndron në çdo moment një punonjës i sigurisë i caktuar posaçërisht për të siguruar rrugë të menjëhershme evakuimi në raste emergjente;

c) në rastin e dyerve të daljes dhe të portave rrethuese, që kontrollohen e hapen nga distanca me mjete elektronike ose magnetike, kontrolli i funksionimit të këtij mekanizmi duhet të vendoset në dhomën e kontrollit. Sistemi i hapjes në distancë testohet para çdo veprimtarie sportive.

Neni 23
**Prania e personelit të sigurisë**

1. Personeli i sigurisë, ofruesit e ndihmës së parë, personeli i shërbimit mjekësor dhe personeli i zjarrfikësve, si dhe njoftuesit e adresimeve për publikun janë në pozicionet e tyre të caktuara brenda dhe rreth mjedisit sportiv, përpara se mjedisi sportiv të hapet për tifozët, dhe qëndrojnë në këto pozicione gjatë gjithë kohës që tifozët janë në stadium e derisa turma të jetë shpërndarë, në përputhje me udhëzimet e punonjësit të Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, ose të oficerit të sigurisë.

2. Pajisjet rrotulluese, dyert dhe portat e hyrje-daljes janë operacionale dhe monitorohen nga personeli i sigurisë.

3. Personeli i sigurisë është i disponueshëm në hyrjet e mjedisit sportiv, te pajisjet rrotulluese dhe në brendësinë e mjedisit sportiv, sipas vlerësimit të oficerit të sigurisë.

4. Personeli i sigurisë është në detyrë brenda mjedisit sportiv për t'u siguruar që tifozët të drejtohen në vendet e tyre pa vonesa dhe konfuzion.

5. Personeli i sigurisë njeh planimetrinë e mjedisit sportiv dhe procedurat e sigurisë, të emergjencës e të evakuimit.

Neni 24
**Kontrolli i tifozëve**

1. Tifozët kontrollohen fillimisht nga personeli i sigurisë në gardhin e perimetrit të jashtëm, nëse ka një të tillë ose në kordonin e jashtëm të krijuar nga personeli i sigurisë në rastin e mjediseve, që nuk kanë një gardh të jashtëm rrethues, për t'u siguruar që vetëm mbajtësit e biletave të afrohen te pajisjet rrotulluese dhe për të bërë kontrollet e para për të parandaluar futjen e objekteve apo të lëndëve të ndaluara në mjedisin sportiv.

2. Kontrollet dhe kërkimet përfundimtare kryhen nga personeli i sigurisë jashtë pajisjeve rrotulluese për t'u siguruar, që:

a) tifozët të hyjnë në pjesën e duhur të mjedisit sportiv;

b) tifozët të mos sjellin në mjedisin sportiv pije alkoolike, fishekzjarrë, flakadanë, lëndë piroteknike dhe sende të tjera të forta, të rrezikshme për jetën e shëndetin e pjesëmarrësve, që ka të ngjarë të përdoren në akte dhune;

c) hyrja është e ndaluar për personat e njohur a të mundshëm që cenojnë rendin e sigurinë ose personat që janë nën ndikimin e alkoolit apo të lëndëve narkotike.

3. Çdo tifoz kontrollohet nga një anëtar i personelit të sigurisë i së njëjtës gjini.

Neni 25
**Mbrojtja e zonës së zhvillimit të veprimtarisë sportive**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive siguron që sportistët e zyrtarët e veprimtarisë sportive të mbrohen nga ndërhyrja e tifozëve në zonën e zhvillimit të veprimtarisë sportive.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive siguron që zona e zhvillimit të veprimtarisë sportive të mbrohet nga ndërhyrja e tifozëve në të.

Neni 26
**Dhoma e kontrollit të mjedisit sportiv**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive, në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren e federatës ndërkombëtare të sportit përkatës, siguron një qasje të integruar për mbrojtjen, sigurinë dhe shërbimet me anë të dhomës së kontrollit të mjedisit sportiv, sistemit të kamerave me qark të mbyllur dhe sistemeve të monitorimit e të komunikimit.

2. Oficeri i mbrojtjes dhe i sigurisë, punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, dhe përfaqësuesit e shërbimeve të tjera mjekësore vendosen në dhomën e kontrollit për të reaguar ndaj incidenteve në mjedisin sportiv dhe rreth tij.

3. Sistemi i kamerave me qark të mbyllur i mjedisit sportiv përdoret nga punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, dhe oficeri i mbrojtjes dhe sigurisë, për të monitoruar tifozët, rrugët e hyrjet në mjedis sportiv, si dhe zonat e shikimit brenda tyre.

4. Në rastin e mjediseve sportive të kategorive 1 dhe 2, ku nuk ka dhomë kontrolli, planet duhet të jenë në dispozicion në një vend të paracaktuar brenda mjedisit sportiv.

Neni 27
**Përsëritjet në ekranet gjigante**

Organizatori i veprimtarisë sportive siguron që imazhet, të cilat shfaqen gjatë veprimtarisë në ekranin gjigant të mjedisit sportiv, nuk nxisin ndonjë formë të prishjes së rendit dhe të sigurisë. Imazhet e shfaqura duhet të respektojnë parimet e *fair-play*-t dhe nuk duhet të jenë me zë.

Neni 28
**Sistemi i adresimit të publikut**

1. Sistemi i adresimit të publikut të mjedisit sportiv duhet të dëgjohet qartë, brenda dhe jashtë mjedisit sportiv, në të gjitha rrethanat, duke marrë parasysh veçanërisht zhurmën e tepërt të turmës.

2. Folësit e trajnuar për të përkthyer në gjuhë të huaj, për tifozët miq të huaj, duhet të jenë të disponueshëm kur kërkohet. Nëse është e mundur, flet një spiker, zëri i të cilit është i njohur për tifozët, që vizitojnë mjedisin sportiv në vendin e tyre.

3. Njoftimet që jepen nëpërmjet sistemit të adresimit të publikut kanë karakter neutral dhe nuk përdoren, për:

a) përhapjen e mesazheve politike;

b) mbështetjen e ekipit vendës;

c) diskriminimin ndaj ekipit mik.

Neni 29
**Sendet e palejuara në mjediset sportive**

1. Ndalohen mbajtja dhe përdorimi në objektet e mjediset sportive dhe gjatë zhvillimit të veprimtarive sportive i fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike dhe sendeve të tjera, të rrezikshme për jetën e shëndetin e pjesëmarrësve, i armëve të të gjitha llojeve, si edhe përdorimi e tregtimi i pijeve alkoolike.

2. Pijet joalkoolike, të cilat shiten apo shpërndahen, të shërbehen në enë letre ose plastike të hapura, që nuk mund të përdoren në mënyrë të rrezikshme.

Neni 30
**Veprimet politike**

Promovimi a njoftimi, me çdo lloj mjeti, i mesazheve politike ose i ndonjë veprimi tjetër politik, brenda dhe në afërsi të mjedisit sportiv, është i ndaluar para, gjatë dhe pas veprimtarisë sportive.

Neni 31
**Veprimet provokuese dhe racizmi**

1. Organizatori i veprimtarisë sportive, së bashku me punonjësin e Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive dhe oficerin e mbrojtjes e të sigurisë, parandalon çdo veprim provokues, që ndërmerret nga tifozët brenda ose në afërsi të mjedisit sportiv, sa i përket provokimit verbal nga tifozët ndaj lojtarëve a tifozëve kundërshtarë, në nivele të papranueshme, sjellje raciste dhe përdorimit të mjeteve ofendues.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive, punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, dhe oficeri i mbrojtjes e sigurisë ndërhyjnë nëpërmjet sistemit të adresimit të publikut ose drejtpërdrejt, në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 32
**Mbajtja e tifozëve në stadium**

Punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, ose oficeri i mbrojtjes e sigurisë vendos që, për arsye sigurie, një grup tifozësh duhet të mbahet brenda mjedisit sportiv, ndërsa tifozët e tjerë të shpërndahen. Sa herë që është e mundur, ky vendim i komunikohet federatës ose klubit mik paraprakisht, në mënyrë që informacioni të mund të përcillet te tifozët e tyre. Në çdo rast:

a) vendimi për të mbajtur një grup tifozësh duhet të shpallet nëpërmjet sistemit të adresimit të publikut në gjuhën e grupit të tifozëve, të cilit i drejtohet;

b) njoftimi duhet të përsëritet pak para përfundimit të ndeshjes;

c) ata duhet të informohen rregullisht për kohën që mund t'u duhet të presin para se të lejohen të largohen nga mjedisi sportiv.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33
**Monitorimi i masave**

Ministria përgjegjëse për sportin monitoron realizimin e masave për parandalimin e dhunës në veprimtaritë sportive nga organizatat sportive, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

Neni 34
**Organet zbatuese**

Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 35
**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 58, datë 26.1.2022**

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR FUNKSIONIMIN E PËRBASHKËT TË SPITALIT RAJONAL "MEMORIAL" NË FIER, GJATË FAZËS KALIMTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier, gjatë fazës kalimtare, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**PROTOKOLL**
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË MBI FUNKSIONIMIN E PËRBASHKËT TË SPITALIT RAJONAL "MEMORIAL" NË FIER, GJATË FAZËS KALIMTARE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Turqisë (këtu e në vijim do të referohen si "Palët"),

*në vijim* të Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë, nënshkruar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Turqisë, më 2 shkurt 2021;

*me qëllim* rregullimin e procedurave dhe parimeve në lidhje me mënyrën e funksionimit gjatë fazës kalimtare të Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier, (këtu e në vijim) do të referohet si "Spitali");

kanë rënë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij Protokolli është transferimi i përvojave përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë së Turqisë, në lidhje me reformën shëndetësore, veçanërisht në fushën e menaxhimit të spitaleve, në Republikën e Shqipërisë përmes Spitalit Rajonal "Memorial".

Spitali Rajonal "Memorial", i vendosur në qytetin e Fierit në Shqipëri dhe i ndërtuar nga Republika e Turqisë, me një kapacitet prej 150 shtretërish, do të ofrojë shërbime shëndetësore për qytetarët që jetojnë në territorin shqiptar dhe do të drejtohet në mënyrë të përbashkët për një periudhë kohore prej tre (3) vjetësh. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së përmendur të drejtimit të përbashkët, afati mund të zgjatet për një vit ose më shumë, nëse Palët e gjykojnë të përshtatshme.

Neni 2
**Përkufizime**

Në këtë protokoll bashkëpunimi termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

**Drejtori i përgjithshëm** i referohet personit të emëruar nga pala shqiptare, përgjegjës për menaxhimin e Spitalit.

**Bordi Drejtues** i referohet organit më të lartë ekzekutiv që është i pavarur në veprimtarinë e tij dhe funksionon si organ kolegjial. Ky Bord do të përbëhet nga pesë anëtarë të palës shqiptare.

**Bordi i Burimeve Njerëzore** i referohet një bordi i cili do të ngrihet nga Bordi Drejtues dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, për të caktuar personelin që do të punësohet në Spital. Vendimet e këtij Komiteti do t'i nënshtrohen miratimit përfundimtar të Bordit Drejtues.

**Këshilli i Trajnimit** i referohet një strukture që drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm turk dhe 2 shefa të shërbimit, shtetas turq, do të veprojnë si anëtarë (*ex-officio*) të Bordit të lartpërmendur.

**Bordi i Etikës** i referohet një strukture të udhëhequr nga Drejtori i Përgjithshëm, i përbërë nga pesë (5) anëtarë, në të cilën zëvendësdrejtori i përgjithshëm turk dhe zëvendësdrejtori i shërbimeve shëndetësore do të veprojnë si anëtarë (*ex-officio*). Anëtarët e Bordit të lartpërmendur do të caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 3
**Monitorimi/inspektimi**

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë do të jenë institucionet monitoruese/inspektuese.

Fushat e zbatimit dhe kushtet e bashkëpunimit të parashikuara nga ky Protokoll do të përcaktohen nga planet e veprimit dhe programet e zbatimit, që do të përgatiten në periudhat kohore, që do të konsiderohen të përshtatshme nga palët. Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë, nëse e gjykojnë të nevojshme, mund të kryejnë veprimtari monitorimi dhe inspektimi përmes krijimit të delegacioneve të përbashkëta.

Neni 4
**Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

**A. Të drejtat dhe detyrimet e palës turke:**

1. Pala turke do të ndajë njohuritë dhe përvojën e saj, në lidhje me planifikimin dhe organizimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore efikase, cilësore, të qëndrueshme dhe të aksesueshme nga Spitali.

2. Pala turke, në përputhje me qëllimet e menaxhimit dhe veprimtarisë së Spitalit, do të caktojë një numër të caktuar personeli turk në pozicionet, të cilat do të jenë rënë dakord nga Palët. Personeli i lartpërmendur do të përbëhet tërësisht nga personel i sektorit publik.

3. Pala turke mund të vendosë lidhje ndërmjet Spitalit në fjalë dhe spitalit/ve të trajnimit dhe kërkimit në Turqi.

4. Pala turke do të sigurojë trajnime afatshkurtra në Turqi për personelin shëndetësor shqiptar që do të punojë në Spitalin Rajonal "Memorial" të Fierit.

Pala turke do t'i japë përparësi pjesëmarrjes së personelit shëndetësor të Spitalit Rajonal "Memorial" në veprimtari ndërkombëtare si kongrese shkencore, seminare dhe simpoziume që do të mbahen në Turqi.

**B. Të drejtat dhe detyrimet e palës shqiptare janë:**

1. Të mbulojë të gjithë koston e funksionimit të Spitalit, nëpërmjet të gjithë mjeteve financiare, sikundër janë përcaktuar në legjislacionin në fuqi dhe në këtë protokoll bashkëpunimi;

2. Të hartojë të gjithë kornizën ligjore për funksionimin e Spitalit si spital pilot, përfshirë dhe aktet përkatëse, për mënyrën e mbulimit të shpenzimeve që lidhen me përfaqësuesit e palës turke;

3. Të mbulojë shpenzimet e brendshme të pagave, akomodimit dhe transportit të personelit që do të emërohen në këtë projekt nga pala turke;

4. Ndërmarrjen e të gjitha veprimeve pranë organeve kompetente për lëshimin e lejes së qëndrimit/punës dhe vizës për personelin turk, që do të emërohet në fushën e këtij Protokolli, duke marrë parasysh detyrat dhe statusin e tyre;

5. Bashkëpunon me urdhrat profesionistë përkatës për lëshimin e lejeve të ushtrimit të profesionit për të gjithë profesionistët mjekësorë turq;

6. Bashkëpunon me institucionet përkatëse për vlefshmërinë e diplomave, certifikatave të trajnimit dhe dokumenteve të tjera përkatëse të lëshuara në Turqi, dhe të mbajtura nga personeli turk për t'u emëruar zyrtarisht nga Turqia në Spital, dhe përcakton që asnjë procedurë e mëtejshme e ekuivalencës nuk do të zbatohet për këtë personel. Lista e emrave të personelit të emëruar në Spital do t'i komunikohet, nga pala turke, palës shqiptare përmes kanaleve zyrtare.

7. Emri i Spitalit "Memorial" do të mbetet i pandryshuar, nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga palët, dhe do të shkruhet si në turqisht "*Turkiye Arnavutluk* Fier *Dostluk Hastanesi*", ashtu edhe në shqip "Spitali Rajonal Memorial".

**C. Të drejtat dhe përgjegjësitë e përbashkëta të palëve:**

1. Palët do të hartojnë rregullore dhe udhëzime të përbashkëta për funksionimin e Spitalit.

Këto rregullore dhe udhëzime do të përfshijnë fusha të tjera që mund të jenë të nevojshme, përfshirë procedurat dhe parimet e funksionimit të Spitalit, sigurimin e kujdesit shëndetësor, punësimin e personelit, procedurat dhe parimet financiare.

Neni 5
**Menaxhimi i Spitalit**

1. Organet drejtuese të Spitalit "Memorial" janë Bordi Drejtues, i cili është organi më i lartë ekzekutiv, që është i pavarur në veprimtarinë e tij dhe funksionon si një organ kolegjial.

2. Ekipi i menaxhimit të Spitalit "Memorial" do të jetë si më poshtë:

a) drejtori i përgjithshëm (shqiptar);

b) nëndrejtori i përgjithshëm mjekësor (turk);

c) nëndrejtori i përgjithshëm ekonomik (shqiptar);

d) nëndrejtori i përgjithshëm (administrim spitalor turk);

e) kryeinfermieri i përgjithshëm 2 (drejtues i shërbimeve shëndetësore, një shqiptar dhe një turk).

3. Drejtuesit e spitalit hartojnë "Udhëzimet operacionale të Spitalit", duke identifikuar procedurat operacionale për funksionimin e Spitalit gjatë periudhës së fazës kalimtare, nga palët turke dhe shqiptare, dhe përshkrimet e punës së personelit në të gjitha nivelet, dhe i miratojnë këto udhëzime në Bordin Drejtues.

4. Përgjegjësitë e drejtorëve të lartpërmendur dhe personelit tjetër të Spitalit përcaktohen nga Bordi Drejtues.

5. Personeli turk emërohet nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë dhe menaxherët shqiptarë emërohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë.

6. Personat për të cilët konstatohet nga autoritetet e të dy vendeve se cenojnë sigurinë kombëtare dhe angazhohen në aktivitete të ndërlidhura me terrorizmin, që rrezikojnë integritetin kombëtar të Turqisë dhe Shqipërisë ose personat që janë të lidhur me persona/organizata të tilla, nuk do të punësohen në spital, dhe shërbimet apo materialet në lidhje me shërbimet spitalore nuk do të prokurohen prej tyre, pavarësisht nga kombësia e tyre. Pala turke do t'iu komunikojë autoriteteve shqiptare kërkesat dhe informacionin në lidhje me personat përkatës, kompanitë dhe organizatat përmes Ambasadës së Republikës së Turqisë në Tiranë. Pala shqiptare do të komunikojë kërkesat dhe informacionin në lidhje me personat, kompanitë dhe organizatat përkatëse tek autoritetet turke përmes Ambasadës së Shqipërisë në Ankara.

7. Punonjësit që janë shtetas shqiptarë do të punësohen në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, përmes lidhjes së një kontrate pune me Spitalin.

Neni 6
**Financimi i Spitalit**

1. Spitali financohet nga buxheti i shtetit të Republikës së Shqipërisë, kontributet e donatorëve dhe të ardhurat e tjera të ligjshme.

2. Rregullat dhe procedurat për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve civile do të zbatohen bazuar në legjislacionin shqiptar.

3. Paga dhe pagesa të tjera të personelit të kontraktuar që do të punojë në Spital, si dhe të gjitha të drejtat e tjera personale, do të mbulohen nga buxheti i Spitalit.

Neni 7
**Përzgjedhja e burimeve njerëzore**

Personeli shqiptar do të emërohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë (drejtori i përgjithshëm) dhe nga drejtori i përgjithshëm i Spitalit "Memorial" Fier personeli tjetër. Paga dhe pagesa shtesë e këtij personeli përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe mbulohet nga buxheti i Spitalit.

Shpërblimi i personelit turk përcaktohet me vendim të Bordit Drejtues, me miratimin e Këshillit të Ministrave.

Bordi i Burimeve Njerëzore do të verifikojë diplomat, certifikatat dhe dokumentet e tjera, të lidhura me edukimin e punonjësve para emërimit të tyre në punë.

Neni 8
**Përgjegjësitë e personelit**

Përgjegjësia disiplinore e personelit që punon në spital rregullohet me legjislacionin shqiptar.

Personeli i emëruar nga pala turke, si edhe të afërmit e tyre do t'i nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve të Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar detyrimet e tyre profesionale, për sa kohë që ndodhen në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9
**Kontributet për Spitalin**

Në mënyrë që Spitali të përmirësohet dhe të ofrojë shërbime më të mira, palët do të bëjnë përpjekje për të marrë ndihmë financiare nga institucionet dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe vendet e tjera.

Neni 10
**Autoritetet zbatuese**

Ky Protokoll i përbashkët zbatohet nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë.

Neni 11
**Konsultimet dhe ndryshimet**

Bazuar në mirëkuptimin e bashkëpunimin e ngushtë, palët herë pas here do të kryejnë konsultime për zbatimin dhe interpretimin, si edhe ndryshimet e këtij Protokolli.

Nëse njëra palë kërkon një konsultë për të ndryshuar këtë Protokoll, përveç nëse vendoset ndryshe, konsultimet do të fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pasi pala tjetër të marrë kërkesën, në çdo rast dhe në çdo rrethanë. Këto konsultime do të kryhen përmes negociatave ose korrespondencës me shkrim. Gjatë këtyre konsultimeve, palët do të përgatisin dhe paraqesin bazat që mbështesin kërkesën e tyre për ndryshim.

Ky Protokoll do të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të palëve. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 14 të Protokollit.

Neni 12
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi, ekzekutimi dhe zbatimi i këtij Protokolli do të zgjidhet bashkërisht dhe në mirëbesim nga njësitë e marrëdhënieve ndërkombëtare të ministrive të shëndetësisë të të dy vendeve. Nëse kjo nuk është e mundur, mosmarrëveshjet zgjidhen sa më shpejt që të jetë e mundur, përkatësisht në nivelet e zëvendësministrit të shëndetësisë, ministrit të shëndetësisë dhe qeverisë.

Neni 13
**Pezullimi**

Në rast të një kërcënimi serioz kundër sigurisë kombëtare, interesave kombëtare dhe sigurisë së jetës, të dështimit të procedurës së zgjidhjes, të përcaktuar në nenin 12, palët do të pezullojnë pjesërisht ose plotësisht zbatimin e këtij Protokolli, pas njoftimit të palës tjetër me shkrim përmes rrugëve diplomatike.

Neni 14
**Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja**

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët do të informojnë njëra-tjetrën, përmes rrugëve diplomatike, për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Ky Protokoll konsiderohet i përfunduar për 3 (tre) vjet dhe do të rinovohet automatikisht për periudha të njëpasnjëshme prej 1 (një) viti, përveç rasteve kur njëra palë njofton me shkrim palën tjetër, me anë të kanaleve diplomatike, për synimin e saj për të përfunduar Protokollin 90 ditë para skadimit të tij.

Ky Protokoll i përbashkët është nënshkruar më 23.11.2021, në gjuhën turke, shqipe dhe angleze, në dy kopje origjinale secila, dhe secila kopje është njësoj e vlefshme. Në rast të ndryshimit në interpretim, versioni anglisht do të mbizotërojë.

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Mira Rakacolli**
Zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË
**Halil Eldemir**
Zëvendësministër i Shëndetësisë

**URDHËR**
**Nr. 11, datë 14.1.2022**

**PËR NJË PLAN MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR NJË SHFRYTËZIM TË QËNDRUESHËM TË REZERVAVE TË PELAGJIKËVE TË VEGJËL NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEOGRAFIKE 17 DHE 18) [REKOMANDIMI I GFCM/44/2021/20]**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 3, të Marrëveshjes, "Për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun", të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003, të neneve 13 dhe 14, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e Rekomandimit GFCM/44/2021/20 të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, "Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për një shfrytëzim të qëndrueshëm të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)", që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Anijet e peshkimit që peshkojnë pelagjikë të vegjël (sardele dhe açuge) të zbatojnë ndalimin në peshkim, për një periudhë 30-ditore, si më poshtë:

- për sardelen 15 shkurt–16 mars;
- për açugen 1 qershor–30 qershor.

3. Ndalohet peshkimi i pelagjikëve të vegjël për anijet mbi 12 m gjatësi të përgjithshme, deri në largësinë 6 milje detare nga bregu për periudhën 1 prill–31 dhjetor.

4. Gjatë periudhës së ndalimit, anijet që peshkojnë pelagjikët e vegjël nuk lejohen të ndërrojnë rrjetat e përdorura, me qëllim peshkimin e tyre nga trata pelagjike në koshilok ose anasjelltas.

5. Ky plan menaxhimi është i zbatueshëm për 7 (shtatë) vijet nga data e miratimit të tij.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Inspektorati i Peshkimit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

7. Urdhri nr. 435, datë 25.7.2019, "Për masat e mëtejshme urgjente në vitet 2019–2021, për rezervat e pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18) [Rekomandimi GFCM/42/2018/8]", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Frida Krifca**

**REKOMANDIM I GFCM/44/2021/20**
PËR NJË PLAN MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR NJË SHFRYTËZIM TË QËNDRUESHËM TË REZERVAVE TË PELAGJIKËVE TË VEGJËL NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEOGRAFIKE 17 DHE 18)

*Duke marrë parasysh* se qëllimi i Marrëveshjes Për themelimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (marrëveshja e GFCM-së) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla detare, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, në zonën e zbatimit të GFCM-së;

*duke kujtuar* që në arritjen e qëllimit të Marrëveshjes së GFCM-së, GFCM-së do të miratojë rekomandime për masat e ruajtjes dhe të menaxhimit, që synojnë sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të aktiviteteve të peshkimit, me qëllim ruajtjen e burimeve të gjalla detare dhe qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të peshkimit dhe, që, në miratimin e rekomandimeve të tilla, GFCM-ja do t'u kushtojë vëmendje të veçantë masave për të parandaluar mbipeshkimin dhe për të minimizuar hedhurinat, si dhe ndikimet e mundshme në peshkimin artizanal dhe komunitetet lokale;

*duke marrë parasysh* se GFCM-ja do të miratojë masat e menaxhimit të peshkimit, bazuar në një qasje në ekosistem për të garantuar ruajtjen e rezervave në nivele të cilat mund japin prodhimin maksimal të qëndrueshëm (MSY);

*duke kujtuar* që Deklarata Ministeriale e Maltës më 2017-ën për zgjerimin e bashkëpunimit për peshkimin dhe akuakulturën në Detin Mesdhe *("MedFish4Ever Declaration")* kërkon që në kontekstin e krijimit të një kuadri të menaxhimit të peshkimit të bazuar në ekosistem, të gjitha format kryesore të peshkimit të menaxhohen me plane

menaxhimi;

*duke marrë parasysh* se GFCM-ja duhet të zbatojë një qasje të kujdesshme në përputhje me Marrëveshjen për Zbatimin e Dispozitave të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit të 10 dhjetorit 1982, në lidhje me Ruajtjen dhe Menaxhimin e Burimeve Peshkore për Speciet Shumë Migruese të 4 gushtit 1995 dhe Kodin e Sjelljes për një Peshkim të Përgjegjshëm të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë së Kombeve të Bashkuara (FAO);

*duke marrë parasysh* se Kodi i Sjelljes i FAO-s për një Peshkim të Përgjegjshëm parashikon që shtetet "duhet të zbatojnë gjerësisht qasjen e kujdesshme në ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve ujore të gjalla, për t'i mbrojtur ato dhe për të ruajtur mjedisin ujor, duke marrë parasysh dëshmitë më të mira shkencore të disponueshme. Mungesa e informacionit të përshtatshëm shkencor nuk duhet të përdoret si arsye për shtyrjen ose mosplotësimin e masave për ruajtjen e specieve objekt peshkimi, specieve të lidhura ose të varura dhe specieve joobjekt peshkimi dhe mjedisin e tyre";

*duke marrë parasysh* se të gjitha masat e formuluara nga GFCM-ja do të bazohen në këshillat më të mira shkencore të disponueshme, duke marrë parasysh faktorët përkatës mjedisorë, ekonomikë dhe socialë;

*duke kujtuar* rekomandimin GFCM/41/2017/7 për një plan rajonal veprimi për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar në zonën e zbatimit të GFCM-së;

*duke marrë parasysh* se vdekshmëria nga peshkimi duhet të mbahet nën pragjet e sigurisë për të siguruar një prodhimtari të lartë afatgjatë, duke limituar riskun e kolapsit të burimeve dhe duke garantuar peshkim më të qëndrueshëm;

*duke marrë parasysh* rëndësinë socioekonomike të peshkimit dhe nevojën për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit;

*duke kujtuar* se një plan menaxhimi (GFCM/37/2013/1) dhe disa masa emergjente tranzitore janë adaptuar, për të ngadalësuar nivelet e larta të vdekshmërisë nga peshkimi, që nga 2013-ta (GFCM/38/2014/1, GFCM/39/2015/1, GFCM/42/2018/8) dhe që këto zbatuan ndalimin në kohë dhe në hapësirë, duke përfshirë dhe kufizimin në zënie;

*duke vënë re* se Komiteti i Këshillimit Shkencor të GFCM-së (SAC) ka konsideruar në mënyrë të përsëritur se rezervat e açuges dhe të sardeles në nënzonat gjeografike (GSA) 17 dhe 18 janë në mbishfrytëzim;

*duke kujtuar* se mbështetur në këshillat më të fundit shkencore të SAC-së më 2021-shin rezervat e açuges dhe të sardeles rezultojnë të mbishfrytëzuara dhe në mbishfrytëzim, për açugen (F/FMSY = 1.51, SSB/SSBlim = 1.05, SSB/SSBpa = 0.80) dhe për sardelen (F/FMSY = 4.43, SSB/SSBlim = 1.11, SSB/SSBpa = 0.67);

*duke vënë re* se Komiteti i Këshillimit Shkencor të GFCM-së (SAC) në mbledhjen e tij të 22-të vuri në dijeni se gjendja e burimeve të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik, pavarësisht masave të marra, ishin të mbishfrytëzuara dhe në mbishfrytëzim (Raporti i Fcurrent/FMSY për açugen 1.51 dhe për sardelen 4.43, respektivisht, biomasa aktuale e rezervave të riprodhueseve ishte midis Bpa dhe Blim për të dyja speciet);

*miraton*, në përputhje me dispozitat e neneve 5b, 8b dhe 13 të Marrëveshjes me GFCM-në, rekomandimin e mëposhtëm.

## PJESA 1
## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË PLANIT SHUMËVJEÇAR

1. Rekomandimi i tanishëm vendos një plan menaxhimi shumëvjeçar për një aktivitet peshkimi pelagjik të qëndrueshëm në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18 GFCM) për shfrytëzimin e rezervave kyçe të pelagjikëve të vegjël (açuge dhe sardele), nga anije me rrethim dhe pelagjike. Në bazë të këshillave të SAC-së, fusha e këtij rekomandimi mund të zgjerohet në vegla dhe në specie të tjera.

2. Plani shumëvjeçar i menaxhimit duhet të jetë në përputhje me qasjen e kujdesshme. Duhet të projektohet për të siguruar prodhim të lartë afatgjatë, në përputhje me Prodhimin Maksimal të Qëndrueshëm (MSY) dhe të garantohet një risk i ulët për kolapsin e rezervave, duke mbajtur aktivitetin e peshkimit dhe industrinë e varur prej tij në nivele të qëndrueshme.

3. Palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC), anijet e të cilave peshkojnë në mënyrë aktive në nënzonat 17 dhe 18 të GFCM-së, dakordësohen për zbatimin e planit

shumëvjeçar të menaxhimit për speciet e rrezikuara dhe në përputhje me objektivat dhe masat e përgjithshme dhe specifike të vendosura në këtë rekomandim.

4. Një grup masash tranzitore menaxhuese të kujdesshme për detin Adriatik do të zhvillohen në mënyrë që të sigurohet se duke minimizuar ndikimet socioekonomike dhe duke finalizuar kështillat shkencore nga SAC-ja, rezervat dhe aktiviteti i peshkimit përparojnë drejt niveleve biologjikisht të qëndrueshme.

5. Plani shumëvjeçar i menaxhimit për këto forma peshkimi do të ndjekë, gjithashtu, reduktimin e aktivitetit të peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (këtu e më poshtë "PPP") në nënzonat 17 dhe 18 të GFCM-së.

***Shtrirja gjeografike***

6. Plani shumëvjeçar i menaxhimit i parashikuar nga ky Rekomandim do të zbatohet në nënzonat 17 dhe 18 të GFCM-së.

*Përkufizime*

7. Për qëllim të këtij Rekomandimi:

a) "$F_{msy}$" nënkupton vlerën e vdekshmërisë nga peshkimi të vlerësuar, që me një model peshkimi të dhënë dhe nën kushtet aktuale mesatare mjedisore, jep prodhimin maksimal afatgjatë, në rastin e açuges dhe sardeles "$F_{msy}$Proxy" e vendosur bazohet në shkallën e shfrytëzimit të Pattersonit me E=0.4;

b) "$B_{lim}$" nënkupton pikën kufitare të referimit, të shprehur me biomasën e rezervës së riprodhueseve, nën të cilën mund të ketë zvogëlim të kapacitetit riprodhues;

c) "$B_{escapment}$" limiti i biomasës nën të cilin rezerva konsiderohet të ketë kapacitet riprodhues të reduktuar, duke përfshirë çdo biomasë të nevojshme të identifikuar;

d) "$F_{cap}$" limit i F-së, i cili përdoret për të dhënë këshilla mbi zëniet, por pa vlerësuar probabilitetin e SSD> $B_{escapment}$;

e) "Rezervat brenda limiteve biologjikisht të sigurta" nënkupton rezervat me një probabilitet të lartë që biomasa e riprodhueseve në fund të vitit paraardhës të jetë më e lartë se pika e referencës e biomasës ($B_{lim}$);

f) "Deti Adriatik" nënkupton nënzonat gjeografike 17 dhe 18 të GFCM-së, të përcaktuara në rezolutën GFCM/33/2009/2;

g) "Anije që peshkon aktivisht" nënkupton çdo anije pelagjike ose me rrethim që peshkojnë rezervat kyçe dhe të autorizuara nga CPC-ja, me flamurin e tyre, për të kryer aktivitete të veçanta peshkimi, gjatë një periudhe të caktuar, në një zonë të caktuar ose për një formë peshkimi të caktuar në kushte specifike;

h) "Rezerva kyçe" nënkupton organizmat detarë që u përket specieve të caktuara;

i) "Açuge" nënkupton peshqit që i përkasin species *Engraulis encrasicolus;*

j) "Sardele" nënkupton peshqit që i përkasin species *Sardina pilchardus;*

k) "Pelagjikë të vegjël" nënkupton rezervat e açuges dhe të sardeles;

l) "Pelagjike" nënkupton anijen e peshkimit që operon e vetme ose çift duke përdorur tratë pelagjike;

m) "Me rrethim" nënkupton anijet e peshkimit që operojnë, duke përdorur koshilok për gjuetinë e pelagjikëve të vegjël;

n) "Peshkim të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (PPP)" ose "Peshkim PPP" nënkupton aktivitetin e përcaktuar në paragrafin 3 të Planit të Veprimit Ndërkombëtar për Parandalimin, Shkurajimin dhe Eliminimin e Peshkimit të Paligjshëm, të Parregulluar dhe të Paraportuar, të 2001-shit, nga FAO, në vijim referuar si "peshkim PPP" dhe duke ndjekur dispozitat e Rekomandimit GFCM/41/2017/7, për një plan veprimi rajonal për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar në zonën e zbatimit të GFCM-së;

o) "Vend zbarkimi i përcaktuar" nënkupton portet, vende afër me bregun, të përcaktuara nga palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC), në përputhje me Rekomandimin GFCM/40/2016/1 për një skemë rajonale mbi masat e ndërmarra nga shtetet port për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar në zonën e zbatimit të GFCM-së, duke përfshirë terminale në det të hapur dhe instalime të tjera për zbarkimin, transbordimin, paketimin, përpunimin, furnizimin me karburant të anijeve të peshkimit, ku lejohet zbarkimi, transbordimi, paketimi dhe/ose përpunimi i produkteve të peshkimit.

PJESA 2
OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË PLANIT SHUMËVJEÇAR TË MENAXHIMIT DHE MASAT TRANZITORE NË NËNZONËN GJEOGRAFIKE 17 DHE 18

8. Plani do të synojë të kontribuojë në objektivat e përmendur në nenin 2 dhe në parimet e listuara në nenin 5 të Marrëveshjes së GFCM-së.

9. Plani, në veçanti duhet:

a) të zbatojë një qasje të kujdesshme të menaxhimit të peshkimit;

b) të sigurojë një shkallë shfrytëzimi të rezervave kyç në nivelet e Prodhimit Maksimal të Qëndrueshëm (MSY), sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 31 dhjetor 2028, duke marrë parasysh ndërveprime të mundshme midis dy specieve;

c) të parandalojë rritjen e kapaciteteve të peshkimit në varësi me vitin 2014;

d) të mbrojë zonat e çeljes dhe të riprodhimit dhe habitatet e rëndësishme për rezervat kyçe;

e) të kontribuojë në zhdukjen e hedhurinave, duke shmangur dhe duke reduktuar, zëniet e padëshiruara, dhe duke siguruar që të gjitha zëniet të zbarkohen;

f) Të sigurojë masat për të rregulluar kapacitetet e peshkimit dhe zëniet në nivelet e vdekshmërisë nga peshkimi të përputhshme me MSY-në, me synimin për të pasur një flotë ekonomikisht të qëndrueshme dhe pa mbishfrytëzuar burimet biologjike detare.

10. Plani i menaxhimit do të bazohet në një qasje me dy faza, nga ku: a) në dy vitet e para, me një vit tranzitor të tretë (në rastin kur kushte të caktuara nuk do të arrihen (neni 12), do të zbatohen kufizime në zënie dhe kufizime në hapësirë dhe në kohë; dhe b) nga 2024 ose 2025, në bazën e të dhënave të reja shkencore, SAC-ja do të vlerësojë gjendjen e rezervave dhe bazuar në Rregullat e Kontrollit të Zënieve (*Harvest Control Rule (HCR))* propozon masa të mëtejshme dhe këshillon kufizime vjetore të zënieve për speciet, në përputhje të dispozitave të pjesëve 2–3–4–5–6 të këtij Rekomandimi, që do të kontribuojnë në arritjen e $F_{msy}$ ose $F_{msy}$Proxy dhe duke qëndruar brenda limiteve të sigurta biologjike.

11. Më 2022-shin dhe 2023-shin duhet të vendoset një regjim tranzitor i peshkimit. CPC-ja duhet të sigurojnë vendosjen e kufizimit të zënieve në nivel kombëtar ose si zënie të përbashkëta për pelagjikët e vegjël, në përputhje me reduktimin vjetor prej 5% për açugen dhe 8% për sardelen në 2022-shin, dhe 5% për açugen dhe 9% për sardelen në 2023-shin. Ky reduktim i tillë duhet të jetë në përputhje me kufizimet e 2021-shit. Bazuar në këtë nen, limiti i zënieve për 2022-shin dhe 2023-shin, me një shpërndarje të përkohshme, është përcaktuar në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij Rekomandimi.

12. Më 2022-shin dhe 2023-shin, CPC-ja do të angazhohet plotësisht për të mbështetur dhe për të përfunduar vlerësimin e rezervave të sardeles dhe Strategjisë së Vlerësimit të Menaxhimit, siç është planifikuar në nenin 16 dhe në përputhje me shtojcën 12 të raportit të SAC 2021. Nëse deri në mbledhjen vjetore të GFCM-së më 2023-shin, vlerësimi i rezervave të sardeles dhe Strategjisë së Vlerësimit të Menaxhimit *(management strategy evaluation (MSE))* nuk do të jenë të plota, atëherë GFCM-ja do të sigurojë që periudha tranzitore të zgjatet me një vit, për të siguruar që vlerësimi i rezervave dhe i MSE-së për sardelen të ketë përfunduar dhe vendos, bazuar në këshillat e SAC-së mbi kufizimet e zënieve, që do të zbatohen më 2024-ën, bazuar në gjendjen më të përditësuar të disponueshme të rezervës.

13. Për CPC-në me zënie të deklaruara më 2014-ën, nën 2 500 tonë, është vendosur një limit i përbashkët i zënieve, ku do të zbatohen të njëjtat reduktime, siç është përcaktuar në nenin 11 dhe për periudhën 2022–2023, limiti i zënieve është përcaktuar në shtojcën 1. CPC-të e përfshira në kushtet e këtij neni, nuk duhet të tejkalojnë 70% të totalit të zënieve të përbashkëta.

14. Kufizimi i zënieve, për periudhën 2022–2023 ose 2024, për CPC-në në nenet 11–13 do të vendoset pa paragjykuar diskutimet që do të zhvillohen në kontekstin e grupit të punës të cituar në nenin 15 të këtij Rekomandimi.

15. Do të vendoset një grup pune nga GFCM-ja më 2022-shin, brenda tridhjetë ditëve kalendarike nga mbledhja e vitit 2022 të SAC-së, në mënyrë që të vendoset një çelës shpërndarjeje i drejtë dhe i barabartë për pelagjikët e vegjël në detin Adriatik, duke marrë parasysh përpjekjet e ndërmarra nga CPC-ja për të menaxhuar peshkimin e pelagjikëve të vegjël dhe zëniet historike, dhe duke zbatuar në disa raste rregulla më strikte se ato të përcaktuara në këtë Rekomandim, bazuar edhe në konsiderata socio-ekonomike.

16. SAC-ja, në mbledhjen e tij të 23-të, në vitin 2022, do të urdhërojë: 1. WGSASP-në për të përfunduar vlerësimin e rezervave të sardeles në 2022; dhe 2. Grupit të Punës, për Vlerësimin e Masave Menaxhuese *(Workshop on the assessment of management measures (WKMSE))* për të kryer një Strategji të Vlerësimit të Menaxhimit për të përcaktuar Rregullat e Kontrollit të Zënieve më të përshtatshme për açugen dhe sardelen për t'u zbatuar në përputhje me nenet 17 dhe 18.

PJESA 3
PLANI I MENAXHIMIT AFATGJATË

17. Është përcaktuar një plan menaxhimi afatgjatë për periudhën 2024 ose 2025–2029. Çdo vit, mbi bazën e këshillave të SAC-së dhe afateve të këshillimit përcaktuar në nenin 35, GFCM-ja duhet të përcaktojë limitin vjetor të zënieve për njërën specie, bazuar në HCR, në përputhje me nenin 18, i cili do të propozohet nga WKMSE-ja dhe do të miratohet nga SAC-ja më 2023-shin ose 2024-ën.

18. HCR-ja për njërën specie, së bashku me masat menaxhuese të lidhura me kufizimet e zënieve, duhet të sigurojë një probabilitet të ulët, që SSB-ja të zbresë nën Blim (5% probabilitet) dhe do të bazohet në secilën:

a) në një strategji HCR me $F_{msy}$ fikse, bazuar në $F_{msy}$ ose $F_{msy}$Proxy dhe $B_{pa}$; ose

b) në një largim të biomasës HCR, bazuar në një shkallë optimale të biomasës të larguar *(Bescapement)* dhe, nëse është i nevojshëm, një limit të vdekshmërisë nga peshkimi ($F_{cap}$);

c) HCR të tjera të propozuara nga WKMSE-ja, në përputhje me termat e referencës së shtojcës 2 të GFCM-së 42/2018/8.

19. Limitet e zënieve të shpërndara midis CPC-së do të bazohen në rezultatet e grupit të punës cituar në nenin 15.

20. Zëniet të cilat tejkalojnë limitin e zënieve të përcaktuar për speciet në fjalë mund të zbriten nga limiti i zënieve të species objekt peshkimi, me kusht që të mos kalojë 9% të limitit të zënies për atë specie. Kjo dispozitë do të zbatohet vetëm kur gjendja e rezervës së specieve jo objekt peshkimi të ndodhet brenda limiteve të sigurta biologjike.

21. Gjatë tre vjetëve të parë, duke filluar nga 2024, për secilën nga speciet, ndryshimi midis limiteve vjetore të zënieve, në krahasim të vitit të mëparshëm, nuk duhet të jetë më shumë se 10% ndërsa për vitet e mbetura të planit nuk duhet të kalojë 20%. Këto kufizime në ndryshueshmërinë midis limiteve vjetore të zënieve nuk do të zbatohen në rastet kur rezervat nuk janë brenda kufijve biologjikisht të sigurta.

*Masat mbrojtëse*

22. Gjatë periudhës tranzitore dhe/ose gjatë planit afatgjatë të menaxhimit, kur këshillat shkencorë tregojnë se biomasa e riprodhueseve për secilin nga rezervat kyç ndodhet nën Blim, bazuar në këshillat shkencore të SAC-së, masa të tjera korrigjuese duhet të ndërmerren nga GFCM-ja për të siguruar kthimin e rezervave mbi nivelet e afta të gjenerojnë MSY. Në veçanti, masa të tilla korrigjuese mund të përfshijnë pezullimin e peshkimit për ato specie dhe reduktimin e përshtatshëm të limiteve të zënieve.

PJESA 4
MASAT TEKNIKE

*Kufizimet në hapësirë dhe në kohë*

23. Gjatë periudhës tranzitore, CPC-ja duhet të zbatojnë kufizime në kohë në nivele flote (pavarësisht se nuk është njëkohësisht për anijet pelagjike dhe me rrethim) në funksion të mbrojtjes së rezervave gjatë periudhës së riprodhimit. Këto kufizime duhet të mbulojnë të gjithë shpërndarjen e pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik dhe të ndikojnë të gjitha flotat që gjuajnë pelagjikët e vegjël, për një periudhë jo më të vogël se 30 ditë të vazhdueshme për segment flote. Anijet që i përkasin flotës së ndikuar nga këto kufizime nuk lejohen të ndërrojnë veglën e përdorur për gjuetinë e pelagjikëve të vegjël (trata pelagjike në koshilok ose anasjelltas) gjatë periudhës së ndalimit. Këto mbyllje do të bëhen gjatë afatit kohor të mëposhtëm:

- për sardelen, nga 1 tetori deri më 31 mars;
- për açugen, nga 1 prilli deri më 30 shtator.

24. Në përjashtim të nenit 23, kufizime të tilla në kohë mund të zbatohen për periudha jo më pak se 15 ditë të vazhdueshme për flotat kombëtare me më pak se 15 anije peshkimi me rrethim dhe/ose pelagjike, që peshkojnë në mënyrë aktive për rezervat e pelagjikëve të vegjël.

25. Gjatë periudhës tranzitore, CPC-të duhet të zbatojnë kufizime në hapësirë për anijet me një gjatësi mbi 12 metra për jo më pak se 9 muaj. Ky kufizim duhet të mbulojë 30% të ujërave territoriale të identifikuara si të rëndësishme për fazat e para të jetës së peshqve.

26. CPC-të duhet të njoftojnë Sekretariatin e GFCM-së, jo më vonë se 30 prill 2022, dhe më pas çdo vit, për kufizimet në hapësirë, të përcaktuara në nenet 23 dhe 25, në ujërat nën juridiksionin e tyre, që ato zbatojnë në funksion të mbrojtjes së zonave të riprodhimit dhe çeljes së pelagjikëve të vegjël.

27. Më 2023-shin grupet e punës për pelagjikët e vegjël duhet të analizojnë dhe vlerësojnë benefitet e kufizimeve në hapësirë dhe kohë, në mënyrë që të përcaktohen kufizime të mëtejshme të përshtatshme, në funksion të mbrojtjes së zonave të riprodhimit dhe çeljes së pelagjikëve të vegjël.

PJESA 5
MASAT MENAXHUESE TË FLOTËS

28. CPC-të duhet të sigurojnë që kapaciteti total i flotës, për anijet pelagjike dhe me rrethim, që peshkojnë në mënyrë aktive rezervat kyç të pelagjikëve të vegjël shprehur në tonazh bruto (GT) dhe/ose tonazh bruto i regjistruar (GRT), fuqi motorike (kw) dhe numër anijesh, të regjistruar si në regjistrin kombëtar dhe të GFCM-së, të mos tejkalohet, gjatë periudhës të zbatimit të këtij Rekomandimi, kapaciteti i flotës së pelagjikëve të vegjël në 2014.

29. Anijet e peshkimit të autorizuara të gjuajnë rezervat kyç të pelagjikëve të vegjël, si anijet pelagjike dhe me rrethim në detin Adriatik duhet të jenë të listuara nga CPC-ja e flamurit.

30. CPC-të njoftojnë Sekretariatin e GFCM-së jo më vonë se 1 gusht të vitit të parë dhe deri në 31 mars për vitet pasardhëse, listën e anijeve të peshkimit që gjuajnë në mënyrë aktive rezervat e pelagjikëve të vegjël gjatë atij viti ose në vitet pasardhëse. Lista duhet të përmbajë, për secilën anije, informacionin e parashikuar në shtojcën 3 të Rekomandimit GFCM/42/2018/5.

31. Secila CPC duhet të sigurojë ngritjen e mekanizmave të përshtatshëm për regjistrimin e secilës anije në regjistrin kombëtar, për regjistrimin e zënieve dhe sforcos me anë të librave të anijes, si dhe monitorimin e aktivitetit të anijeve të peshkimit dhe të zbarkimeve, duke kryer kampionime të sforcos dhe të zënieve, në përputhje të rregullave të përcaktuara nga secila CPC.

32. Dispozitat e mësipërme nuk paragjykojnë Rekomandimin GFCM/33/2009/7, në lidhje me standardet minimale për ngritjen e një sistemi monitorimi të anijeve në zonën e zbatimit të GFCM-së.

33. Në përjashtim të nenit 28, flotat kombëtare me më pak se 10 anije me rrethim dhe/ose pelagjike që gjuajnë në mënyrë aktive rezervat e pelagjikëve të vegjël, të regjistruara si në regjistrin kombëtar, si te GFCM-ja më 2014-ën, duhet të sigurojnë që kapaciteti total i flotës, shprehur në tonazh bruto (GT) dhe/ose tonazh bruto i regjistruar (GRT), fuqi motorike (kw) dhe numër anijesh, të mos rritet me më shumë se 50%, gjatë periudhës së zbatimi të këtij Rekomandimi.

PJESA 6
MONITORIMI SHKENCOR,
PËRSHTATJA DHE NDRYSHIMI I PLANIT

34. SAC-ja duhet të sigurojë, në bazë vjetore duke filluar nga 2022-shi, këshilla mbi statusin e rezervave kyç në detin Adriatik përfshirë këtu objektiva specifikë, për të mbajtur vdekshmërinë e peshkimit brenda kufijve të vdekshmërisë nga peshkimi, të dakordësuar dhe të mbajnë ose rivendosin rezervat kyç në nivelet e afta për të gjeneruar prodhimin maksimal të qëndrueshëm, në përputhje me objektivat e përcaktuar në nenin 9.

35. Meqenëse një ofrim i shpejtë i këshillave shkencore është thelbësorë për një menaxhim korrekt të specieve jetëshkurtër, siç janë rezervat e pelagjikëve të vegjël, në bazë vjetore, CPC-të duhet të sigurojnë të dhëna nga peshkimi për qëllime shkencore *(echo-survey)* dhe peshkimi tregtar (zëniet dhe hedhurinat), të grumbulluara në vitin N, të dërgohen te Sekretariati i GFCM-së nga 1 prilli (viti N+1), për të kryer një përditësim vjetor të vlerësimit të rezervave në maj (viti N+1). Duke filluar nga viti 2024 ose 2025, në bazë vjetore, mbështetur në këshillat shkencore dhe në HRC, duke marrë parasysh efektet socioekonomike në flotë dhe industri, SAC-ja duhet të propozojë kufizime në zënie për njërën specie, për t'u miratuar nga komisioni i GFCM-së në mbledhjen vjetore (viti N+1) dhe të implementohet nga 1 janari (viti N+2).

36. Mbështetur në këshillat e SAC-së, GFCM-ja mund të rishikojë përmbajtjen e planit shumëvjeçar të menaxhimit.

37. Kur këshillat e SAC-së tregojnë se objektivat e përgjithshëm ose specifikë të planit shumëvjeçar të menaxhimit nuk janë arritur, GFCM-ja duhet të vendosë masa menaxhuese shtesë dhe/ose alternative, që të kontribuojnë në arritjen e qëllimit.

38. Kur, për çdo rast (p.sh. mungesë të dhënash), SAC-ja nuk do të jetë në gjendje të japë një këshillë të detajuar mbi gjendjen e rezervave kyçe dhe mbi shkallën e tyre të shfrytëzimit, GFCM-ja duhet të vendosë mbi masat menaxhuese më të përshtatshme për të siguruar qëndrueshmërinë e peshkimit. Këto masa duhet të mbështeten në këshillat e SAC-së, në përputhje me qasjen e kujdesshme dhe duke marrë parasysh elementet mjedisore dhe socioekonomike, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e peshkimit.

PJESA 7
MASAT SPECIFIKE PËR TË ADRESUAR AKTIVITETET E PESHKIMIT PPP

39. CPC-të duhet të përcaktojnë një mekanizëm për të siguruar që anijet e peshkimit që peshkojnë në mënyrë aktive në detin Adriatik të deklarojnë zëniet e rezervave kyç. Detyrimi për deklarimin elektronik të zënieve, si dhe i specieve jo objekt peshkimi, në sasi më të mëdha se 50 kg, do të zbatohet pavarësisht nga vëllimi i zënieve të anijeve më të mëdha se 12 m dhe të atyre, zëniet e të cilave kalojnë 10 000 kg në vit, pavarësisht gjatësisë nga 1 janari 2022, ndërsa për anijet me gjatësi nën 12 m, që zënë më pak se 10 000 kg në vit, CoC do të vlerësojë sistemin më të mirë për të raportuar zëniet.

40. Secila CPC duhet të përcaktojë vendzbarkime, ku anijet që peshkojnë në mënyrë aktive rezervat kyç në detin Adriatik të zbarkojnë zëniet e tyre.

41. Për secilin port të përcaktuar, CPC-ja duhet të specifikojnë kohën e zbarkimit dhe të transbordimit.

42. CPC-ja duhet të kryejnë inspektime mbi bazën e analizës së riskut.

43. Është e ndaluar të zbarkohet ose të transbordohet nga anijet e peshkimit çdo sasi të rezervave kyç të zëna nga anije pelagjike dhe me rrethim në detin Adriatik, në çdo kohë dhe port të përcaktuar nga CPC-ja, në përputhje me nenin 40.

44. CPC-ja duhet t'i transmetojnë Sekretariatit të GFCM, jo më vonë se 30 prill 2022, gjithashtu dhe brenda 30 nëntorit të secilit vit, çdo ndryshim në listën e vendzbarkimeve të përcaktuara për zbarkimin e rezervave kyç në detin Adriatik.

45. CPC-ja duhet të angazhohen në bashkëpunimin për të luftuar aktivitetet e peshkimit PPP, në veçanti përmes shkëmbimit të informacionit dhe mbledhjes së informacionit për të luftuar aktivitete të paligjshme.

46. Pjesa 7 e këtij Rekomandimi nuk përjashton zbatimin e Rekomandimit GFCM/41/2017/7 për një plan veprimi rajonal, për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar në zonën e zbatimit të GFCM-së.

PJESA 8
PROGRAMI I MONITORIMIT PËR KONTROLLIN DHE MBIKËQYRJEN

47. Anijet që përdorin trata pelagjike ose koshilok, për zënien e rezervave të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik, duhet të lejohen vetëm të kryejnë aktivitete të caktuara peshkimi, nëse këto tregohen në një autorizim të vlefshëm peshkimi të lëshuar nga autoritetet kompetente.

48. Duke filluar nga 30 prilli 2022, anijet e autorizuara me gjatësi mbi 12 m duhet të pajisen me Sistemin e Monitorimit të Anijeve *(vessel monitoring system (VMS)*. CPC-të mund të përjashtojnë anijet me një gjatësi më të vogël se 15 m nga detyrimi për t'u pajisur me VMS, nëse ato operojnë ekskluzivisht në ujërat territoriale të CPC-së dhe/ose nuk qëndrojnë më shumë se 24 orë në det nga koha e nisjes dhe e kthimit në port. CPC-ja duhet të njoftojnë Sekretariatin e GFCM-së për këto përjashtime, si dhe për masat e tjera të kontrollit të vendosura për të monitoruar anijet e peshkimit në fjalë pa vonesa.

49. CPC-ja duhet të monitorojnë konsumin e limitit të zënieve ose kuotën totale të lejuar, të përcaktuar, në përputhje me nenet 11–13 dhe të shtojcës 1 deri në fund të periudhës tranzitore dhe, më pas, në zbatim të nenit 17, si më poshtë:

I. Për CPC të vetme limiti i zënieve, nga periudha kur 80% e kuotës është konsumuar, CPC në fjalë duhet të njoftojë GFCM-në për zëniet në bazë mujore. Ky raportim duhet të dërgohet brenda datës 15 të muajit për muajin paraardhës. Kur limiti i zënieve është arritur, CPC-të duhet të ndalojnë zëniet e pelagjikëve të vegjël ose të njërës specie, në zbatim të nenit 20.

II. Në rastin e limitit të përbashkët të zënieve, CPC-të duhet të njoftojnë në bazë mujore zëniet. Ky raportim duhet të dërgohet brenda datës 15 të

muajit, për muajin paraardhës. Sekretariati i GFCM-së, kur 70% e limitit të përbashkët të zënieve është konsumuar ose një nga CPC-të ka arritur 70% të totalit të limitit të zënieve të përbashkëta, duhet të njoftojë CPC-në në fjalë, të cilat duhet të vendosin një regjim për aktivitetin e peshkimit, në mënyrë që të mos tejkalohet limiti i përbashkët i peshkimit i përcaktuar. Kur limiti i përbashkët i peshkimit është arritur, CPC-të duhet të ndalojnë zënien e pelagjikëve të vegjël ose së njërës specie.

PJESA 9
SKEMA E PËRHERSHME E INSPEKTIMIT

50. Skema pilot e inspektimit për pelagjikët e vegjël në Adriatik, bazuar në Rekomandimin e GFCM/42/2018/8, duhet të zgjatet deri në 31 dhjetor 2023.

51. Nga 1 janari 2024, GFCM-ja duhet të vendosë një program të përhershëm vëzhgimi dhe inspektimi për të siguruar përputhshmëri me masat menaxhuese dhe konservuese të përmbajtura në këtë Rekomandim.

52. Programi i përhershëm i vëzhgimit dhe i inspektimit (neni 51) duhet të bazohet në rezultatet e projektit pilot (neni 50). Ai do të përmbajë, ndër të tjera, elementet e mëposhtme:

a) inspektim në det të hapur;

b) procedurat për hetimin efektiv të një shkeljeje të mundshme të masave të ruajtjes dhe të menaxhimit, të përfshira në këtë Rekomandim, dhe për raportimin në GFCM mbi masat e marra, përfshirë edhe procedurat për shkëmbimin e informacioneve;

c) dispozitat për veprimet që duhet të ndërmerren kur inspektimet evidentojnë shkelje të rënda, si dhe ndjekja e duhur dhe transparente e këtyre veprimeve, në mënyrë që të mbështetet përgjegjësia e shtetit flamur brenda, sipas programit;

d) inspektime në port;

e) monitorimi i zënieve dhe i zbarkimeve, duke përfshirë ndjekjen statistikore për qëllime menaxhimi;

f) program monitorimi specifik, duke përfshirë imbarkimin dhe inspektimin.

PJESA 10
PLANET KOMBËTARE TË MENAXHIMIT

53. Me qëllim të sigurimit të konservimit të përshtatshëm të rezervave të pelagjikëve të vegjël, palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC) duhet të zbatojnë masa menaxhuese ose plane kombëtare menaxhuese në detin Adriatik.

54. CPC-ja duhet të njoftojnë Sekretariatin e GFCM, nga 30 shtatori 2022, mbi masa menaxhuese ose plane menaxhuese të zbatuara në nivel kombëtar. Aty ku është e përshtatshme, nëse këto masa modifikohen, CPC-ja do t'i komunikojnë këto modifikime deri më 30 prill të vitit pasardhës.

PJESA 11
DISPOZITAT E FUNDIT

55. Ky plan qëndron në fuqi për shtatë vjet nga data e miratimit të tij.

56. Masat e përmendura në këtë Rekomandim nuk do të paragjykojnë masat më strikte të miratuara nga CPC-të.

57. Mbi bazën e këshillave shkencore, SAC-ja mund të ndryshojë këtë Rekomandim.

SHTOJCA 1

Mundësia për të peshkuar në detin Adriatik (nënzonat 17–18) pelagjikët e vegjël gjatë periudhës tranzitore 2022–2023, duke përfshirë një vit të mundshëm (2024), në rast se nuk plotësohen kushtet e përmendura në nenin 12. Në përputhje me nenet 11–13, duke filluar nga limiti i zënieve të vitit 2021, limiti i zënieve të specieve të kombinuara është raportuar në tabelën si më poshtë.

| **Speciet** | **EU 2022** | **EU 2023** | **[EU 2024]** | **Limiti i përbashkët i zënieve 2022** | **Limiti i përbashkët i zënieve 2023** | **[Limiti i përbashkët i zënieve 2024]** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Açuge dhe sardele të kombinuara | 91998 | 84976 | [] | 4650 | 4301 | [] |

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 15
Datë: 2022/01/31 15:43:12
04eca422-ab83-4184-b50c-6ca11a9abe94

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 432 lekë